

20140431270

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR REVIZION TË
INSTRUMENTIT PËR NDIHMË PARAADERUESE (IPA)

Neni 1

Në Ligjin për revizion të instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 66/10), në nenin 2, pika 1 fjalët: "për periudhën 2007 - 2013" shlyhen.

Neni 2

Në nenin 5 shtohet paragraf i ri (1) si vijon:

(1) Për emërim të kryerevizorit për IPA-në dhe zëvendësit publikohet shpallja publike në së paku tri gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat një nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase."

Në paragrafin (1) i cili bëhet paragraf (2), pas pikës 3 shtohen dy pika të reja 4 dhe 5 si vijojnë:

„4) të posedojnë njërën nga certifikatat vijuese të njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

- TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
- IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
- ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
- FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë,
- BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë apo
- APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2) dhe

5) ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet."

Pikat 4 dhe 5 bëhen pika 6 dhe 7.

Neni 3

Pas nenit 14 shtohen tri nene të reja 14-a, 14-b dhe 14-v, si vijojnë:

“Neni 14-a

(1) Të punësuarit në Trupin e Revizorit kanë status të nëpunësve administrativë apo personave ndihmës-teknikë.

(2) Nëpunësit administrativë nga paragrafi (1) të këtij neni mund të jenë:

- revizorë të IPA-së që kryejnë revizion të IPA-së, apo
- nëpunës shtetërorë që kryejnë punë administrative në funksion të kryerjes së kompetencave të Trupit të Revizorit të caktuar me këtë ligj.

(3) Për çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës për të punësuarit nga paragrafi (2) të këtij neni që nuk rregullohen me këtë ligj dhe me marrëveshjen kolektive, zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunës administrativë dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

(4) Personat ndihmës-teknikë janë të punësuarit në Trupin e Revizorit që kryejnë punë të mirëmbajtjes, kryerjes së transportit si dhe punë tjera ndihmëse dhe juridike dhe për këta zbatohen rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune."

Neni 14-b

(1) Për nëpunësit administrativë në Trupin e Revizorit që kryejnë revizion të IPA-së përcaktohen nivelet vijuese të vendeve të punës dhe përshkruhen titujt në vijim:

- niveli B1 Këshilltar i kryerevizorit për IPA-n,
- niveli B2 ndihmës i kryerevizorit për IPA-n,
- niveli B3 udhëheqës i Sektorit për Përparimin e Revizionit,
- niveli V1 revizor i pavarur,
- niveli V2 revizor i lartë,
- niveli V3 revizor dhe
- niveli V4 revizor i ri.

Neni 14-v

(1) Rrogat e revizorëve të IPA-së përcaktohen në bazë të koeficienteve edhe atë:

- niveli B1 koeficienti 3,50,
- niveli B2 koeficienti 3,30,
- niveli B3 koeficienti 3,12,
- niveli V1 koeficienti 2,92,
- niveli V2 koeficienti 2,74,
- niveli V3 koeficienti 2,55 dhe
- niveli V4 koeficienti 2,27.

(2) Nëpunësit administrativë që nuk kryejnë revizion të IPA-së pranojnë rrogë në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë."

Neni 4

Në nenin 16 paragrafi (1), pas pikës 1 shtohet pikë e re 2 si vijon:

"2) të kenë certifikatë për titullin e fituar nga sfera e revizionit;"

Pikat 2 dhe 3 bëhen pika 3 dhe 4.

Neni 5

Pas nenit 17 shtohet Kaitull i ri III-a. Avancimi, vlerësimi dhe përsosja profesionale e revizorëve të IPA-së, me tri nene të reja: 17-a, 17-b dhe 17-v, si vijojnë:

“III-a. Avancimi, vlerësimi dhe përsosja profesionale e revizorëve të IPA-së

Neni 17-a

(1) Procedura për avancim ka për qëllim t'u mundësojë revizorëve të IPA-së, avancim në karrierë, përkatësisht kalim nga vendet më të ulëta të punës në vende më të larta të punës.

(2) Në titull më të lartë mund të avancohet revizori i IPA-së, i cili:

1) në dy vlerësimet e fundit është vlerësuar me "dallohet";

2) ka kaluar së paku dy vjet në titullin rrjedhës dhe

3) nuk i është shqiptuar masë disiplinore në vitin e fundit para parashtrimit të propozimit për avancim nga ndihmësi i Kryerevizorit të IPA-së.

(3) Për fillim të procedurës për avancim, ndihmësi i Kryerevizorit për IPA-në, përkatësisht udhëheqësi i Sektorit për Avancim të Revizionit të Kryerevizorit për IPA-në, dorëzon propozim për avancim të revizorit përkatës të IPA-së, me ç'rast e thekson titullin më të ulët në të cilën revizori i IPA-së i kryen detyrat e punës, si dhe titullin më të lartë në të cilën revizori i IPA propozon të avancohet, si dhe arsyet për shkak të së cilave konsideron se revizori i IPA-së duhet të avancohet në titull më të lartë.

(4) Kryerevizori i IPA-së, në kornizat e buxhetit të përcaktuar të Trupit të Revizorit, e në bazë të propozimit nga ndihmës Kryerevizori për IPA-në dhe mendimi nga Sektori për Avancim të Revizionit, vendos nëse propozimin do ta pranojë apo refuzojë.

(5) Për vendimin e miratuar për avancim Kryerevizori për IPA-në, siguron pëlqim nga Ministria e Financave.

Neni 17-b

- (1) Revizorët e IPA-së, përveç Kryerevizorit, vlerësohen një herë në vit, më së voni deri në fund të janarit në vitin rrjedhës për vitin paraprak.
- (2) Vlerësimin e revizorëve të IPA-së e kryen revizori udhëheqës revizor i drejtpërdrejtë.
- (3) Vlerësimi vjetor i revizorëve të IPA-së mund të jetë:
 - 1) "dallohët";
 - 2) "mjaftueshëm" dhe
 - 3) "pamjaftueshëm".
- (4) Kriteret në bazë të së cilave do të bëhet vlerësimi i përcakton Kryerevizori për IPA-në, për çka miraton akt të posaçëm intern.

Neni 17-v

- (1) Revizori i IPA-së në mënyrë profesionale përsoset gjatë vitit.
- (2) Për përsosjen profesionale të revizorëve të IPA-së, Kryerevizori për IPA-në miraton Plan vjetor për trajnime.
- (3) Trupi i Revizorit mban evidencë për llojin dhe numrin e trajnimeve të zbatuara, me qëllim të hartimit të Planit vjetor për trajnime."

Neni 6

Kryerevizori për IPA-në dhe zëvendësi i tij të emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të nenit 2 të këtij ligji vazhdojnë ta kryejnë funksionin deri në kalimin e mandatit për të cilin janë emëruar.

Neni 7

Dispozitat e nenit 2 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen një vit nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave që i referohen kushtit për njohjen e gjuhës së huaj të cilat do të fillojnë të zbatohen dy vjet nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç dispozitave nga nenet 3 dhe 5 të këtij ligji që do të fillojnë të zbatohen nga dita e zbatimit të Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14).